



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2018

Lënda: Dërgohet formulari i njoftimit të fituesit (Kopje e përmbledhur e cila do të publikohet në buletin)

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
Pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë**

Autoriteti Kontraktor: Adresa, nr. tel: Bashkia Shkodër L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", tel+35522400150.

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur (prokurim publik me mjete elektronike).

Objekti i prokurimit ( nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): "Blerje karburant për nevojat e Bashkisë dhe të Institucioneve të Varësise së Bashkisë (Blerje e Përqendruar)".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61020-04-05-2018

Fondi limit ( nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): 20 244 281 (Njzetmilione e dyqind e dyzet e katermije e dyqind e tetedhete e nje )leke pa tvsh.

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë viti 2018.

Vlera e shpallur fituese (nqs ka lotë e ndarë sipas loteve): 20 244 281 (Njzetmilione e dyqind e dyzet e katermije e dyqind e tetedhete e nje )leke pa tvsh

Gazoil 10 ppm me marzh fitimi e shprehur në përqindje 12.6%.

Benzine pa plumb me marzh fitimi e shprehur në përqindje 12.6%.

Data e zhvillimit të tenderit: data 30.04.2018, ora 10.00 vendi: Njesia e Prokurimeve Publike Bashkia Shkodër.

Operatori/et ekonomik i/të shpallur fitues: "Kastrati" sh.p.k NUIS J 61813529 P & "Kastrati" sh.a NUIS K 21711502 V perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik "Kastrati" sh.p.k. Adresa: Lagja 14, Rruga "Tirana", prane Gjykates se Apelit-Shkozet, NUIS J 61813529 P.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
VOLTANA ADEMI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMEVE**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Data 11 / 05 / 2018**

**Nga:** Bashkia Shkodër. Adresa: L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", Tel & Fax +35522400150.

**Për:** Kastrati"sh.p.k NUIS J 61813529 P & 'Kastrati" sh.a NUIS K 21711502 V perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik"Kastrati"sh.p.k. Adresa: Lagja 14, Rruga "Tirana", prane Gjykeses se Apelit-Shkozet, NUIS J 61813529 P.

-Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur .

-Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61020-04-05-2018.

Fondi limit ( nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): Blerje karburant për nevojat e Bashkisë dhe të Institucioneve të Varësise së Bashkise(Blerje e Përqendruar)".

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkise viti 2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

- i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;
- iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

-Afati i realizimit të furnizimit: Nga nënshkrimi i kontrates deri me 31.12.2018

-Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike datë 10.04.2018 nr.14.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 30.04.2018, ora 10.00.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1-Bashkimi i operatoreve ekonomik "Eroil" sh.a.** Nuis L 32230076 S & "Das Oil" sh.p.k Nuis L52230020 G, perfaqesuar me prokure te posacme nga "Das Oil" sh.p.k. me administrator z.Hysen Balla, Nuis L52230020 G me oferten ekonomike 20 244 281 (Njzetmilione e dyqind e dyzet e katermije e dyqind e tetedhete e nje )leke pa tvsh, per karburant me marzh fitimi e shprehur në përqindje **9.6 %** (Nente pike gjashte)

**2.Bashkimi i operatoreve ekonomik"Kastrati"sh.p.k** NUIS J 61813529 P & 'Kastrati" sh.a NUIS K 21711502 V perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik"Kastrati"sh.p.k. me administrator z.Shefit Kastrati NUIS J 61813529 P me oferte ekonomike 20 244 281 (Njzetmilione e dyqind e dyzet e katermije e dyqind e tetedhete e

nje)leke pa tvsh, per Gazoil 10 ppm me marzh fitimi e shprehur në përqindje 12.6%.(Dymbëdhjete pike gjashte) per Benzine pa plumb me marzh fitimi e shprehur në përqindje 12.6%.(Dymbëdhjete pike gjashte)

Ka ofertues te skualifikuar.

**1-U skualifikuan bashkimi i operatoreve ekonomik “Eroil” sh.a. &”Das Oil’ sh.p.k per keto arsye:**

- 1- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eroil” sh.a. & “Das Oil” sh.p.k., nuk ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht, ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me kontratën e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme, me të gjithë elementët konkretë të nevojshëm për një procedurë prokurimi, duke dhënë detaje të rëndësishme si në lidhje me autoritetin kontraktor, objektin e prokurimit, afatin, elementët konkretë të domosdoshëm për këtë objekt prokurimi, duke mos përmbushur kriterin për paraqitjen e këtij dokumenti të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor.
- 2- Shtojcat e paraqitura nga bashkimi i OE janë me gabime në vlerat e fondit limit të përshkruar.
- 3- Oferta e paraqitur nga DAS OIL - nuk është sipas shtojces nr. 2, nuk ka të specifikuar marzhin e fitimit për gazoil dhe për benzinë pa plumb sipas nevojave të AK por e ka në total karburant. Gjithashtu, fondi limit dhe vlera e lëndëve djegëse është gabim.
- 4- Vërtetimi leshuar nga OSHEE për subjektin Das Oil sh.p.k nuk përfshin muajin e fundit të maturuar që është muaji shkurt 2018.
- 5- Për operatorin EROIL mungon bilanci i vitit 2017, gjithashtu edhe operatorit DAS OIL I mungon bilanci i vitit 2017.
- 6- Asnjëri nga operatorët ekonomik nuk ka paraqitur një deklaratë të gjëndjes financiare nga një ose më shumë banka sa 10% e vlerës së kontratës që prokurohet 2 024 428 lekë.
- 7- Mungojnë vërtetimet për shlyerjen e taksave vendore nga subjekti Das Oil sh.p.k ashtu edhe të subjektit EROIL shpk
- 8- Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur asnjë kontratë për stacionet e karburantit në Bashkinë Shkodër por vetëm një listë të stacioneve të ALPET në Shqiperi që nuk është i rregullt as ne formë as në përmbajtje.
- 9- Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur asnjë deklaratë doganore të kerkuar në DST të gjatë 6 muajve te fundit nga data hapjes së ofertave.
- 10- Ne lidhje me mjetin bot për transport karburanti është paraqitur certifikata e transportit e cila është e palexueshme.
- 11- Asnjëri prej operatorëve pjesë e këtij bashkimi nuk ka paraqitur deklaratë që duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura ne karten elektronike te personalizuar me targon e mjetit ose bot ne leng, deri ne perfundimin e plote te kontrates, sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike duhet te jenë pa skadencë dhe të konsumueshem

edhe gjatë vitit 2019, se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve ekonomik **”Kastrati”sh.p.k** NUIS J 61813529 P & **’Kastrati” sh.a** NUIS K 21711502 V perfaqesuar me prokure te posacme nga operatori ekonomik **”Kastrati”sh.p.k.** me administrator z.Shefit Kastrati NUIS J 61813529 P.Adresa:Lagja 14,Rruga “Tirana”,prane Gjykates se Apelit,Shkozet-Durres, se oferta e paraqitur 20 244 281 (Njzetmilione e dyqind e dyzet e katermije e dyqind e tetedhjete e nje )leke pa tvsh per

Gazoil 10 ppm me marzh fitimi e shprehur në përqindje 12.6%.(Dymbedhjete pike gjashte)  
Benzine pa plumb me marzh fitimi e shprehur në përqindje 12.6%.(Dymbedhjete pike gjashte)  
është identifikuar si oferta e suksesshme

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesise se Prokurimeve Publike,Bashkia Shkodër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.Gjithashtu duhet te paraqitni te gjithe dokumentacionin e hedhur ne tender origjinal ose kopje te noterizuar, te numerizuar dhe te inventarizuar.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) ], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 03.05.2018.

Ankesa:Nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**VOLTANA ADEMI**

